



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS

NJOFTIM PËR SHTYP

Komisioni i Konkurrencës, në mbledhjen e tij më datë 24.05.2023, mori në shqyrtim tre njoftime përqendrimi.

1. Përqendrimi i realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të vetëm të shoqërisë Shanghai Muchuan Industrial Design Co., Ltd nga shoqëria CARIAD Estonia AS.
2. Përqendrimi i realizuar nëpërmjet blerjes të aksioneve të shoqërisë Peel NRE Wind Farms (Yell) Limited dhe Peel NRE Wind Farms (No.1) Limited nga shoqëria Statkraft UK Ltd..
3. Përqendrimi i realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë Gruppo Zaffiro S.r.l. nga shoqëritë Eurizon Capital Real Asset S.G.R S.p.A. dhe Sarafin S.p.A..

Përqendrimet e njoftuara nuk krijojnë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, nuk do të sjellin asnjë ndryshim dhe nuk do të kenë ndikim në tregun shqiptar.

Për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës me me Vendimin nr. 985, datë 24.05.2023, vendosi të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të vetëm të shoqërisë Shanghai Muchuan Industrial Design Co., Ltd nga shoqëria CARIAD Estonia AS.; me Vendimin nr. 986, datë 24.05.2023, vendosi të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet blerjes të aksioneve të shoqërisë Peel NRE Wind Farms (Yell) Limited dhe Peel NRE Wind Farms (No.1) Limited nga shoqëria Statkraft UK Ltd.; dhe Vendimin nr. 988, datë 24.05.2023, vendosi të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë Gruppo Zaffiro S.r.l. nga shoqëritë Eurizon Capital Real Asset S.G.R S.p.A. dhe Sarafin S.p.A.

Për më tepër, ju lutem konsultoni faqen zyrtare të Autoritetit të Konkurrencës në <http://caa.gov.al>.